



Funded by
the European Union




MUZEU ETNOGRAFIK I KAVAJËS

CH
WB

Cultural
Heritage without Borders
ALBANIA





MUZEU ETNOGRAFIK I KAVAJËS



Ky libërth është krijuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përbajtja e tij është përgjegjësi e vetme e CHwB Albania dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian dhe/ose UNOPS-it.



KE SHKUAR NDONJËHERË NË NJË MUZE ETNOGRAFIK?



Në një muze etnografik mësojmë sesi kanë jetuar më parë njerëzit. Të vizitosh një vend të tillë do të thotë të bësh një udhëtim pas në kohë, i cili na zgjon dëshirën për ta njohur sa më mirë dhe për të ruajtur trashëgiminë tonë kulturore.

Çdo vend ka trashëgiminë e vet të larmishme e cila mund të jetë e prekshme, si ndërtesat apo objektet. Por ajo mund të jetë edhe shpirtërore, si këngët e vallet popullore, përrallat, dijet e prodhimit të veshjeve, ushqimeve, mjeteve të punës, etj.

Zbulo më shumë për Muzeun Etnografik të Kavajës dhe trashëgiminë e saj të veçantë.



KËTA JANË MUZETË ETNOGRAFIKË NË SHQIPËRI

Vendos germën e duhur në emërtimet e muzeve etnografikë.

Muzeu i Beratit ___

Muzeu i Vlorës ___

Muzeu i Gjirokastrës ___

Muzeu i Kavajës ___

Muzeu i Krujës ___

Muzeu i Elbasanit ___

Muzeu i Kukësit ___

Muzeu i Durrësit ___



a.



b.



d.



dh.



c.



ç.



e.



ë.

Ndërtesa ku ndodhet sot muzeu etnografik është një shtëpi tipike kavajase. Ajo i përkiste familjes Arkaxhi dhe ka një formë të rregullt simetrike, si dhe një oborr të madh.

Çfarë të pëlqen më shumë nga kjo shtëpi?



Në shekullin XIX, Kavaja, ky qytet i Shqipërisë së Mesme, ka qenë shumë i njohur. Ajo qe një qendër e rëndësishme tregtie me pazarin e saj që gumëzhinte nga lëvizjet e njerëzve dhe thirrjet e tregtarëve. Në zemër të pazarit, Kulla e Sahatit shërbente si pikë referimi për të gjithë zonën.



Si në të gjitha qytetet e Shqipërisë në atë kohë, pazari i Kavajës ndodhej në qendër të qytetit.

Aty, mjeshtrat artizanë poçarë, bakërpunues, qëndistarë e jorganxhinj prodhonin mallra për banorët e qytetit, por edhe për ata që vinin nga larg.

E gjen dot se çfarë po bëjnë mjeshtrat? Plotëso emrat e punishteve të tyre.






Traditë e grave kavajase ishte punimi i tekstileve dhe pëlhurave të pambukta e të mëndafshta. Me to prodhonin veshje, mbulesa, e më vonë edhe qilima.

Në të shkuarën, qeleshet dhe qëndisjet prej ari të jelekëve dhe xhokeve i bënin burrat, por sot si vajzat, edhe djemtë mund të mësojnë t'i bëjnë ato.



Bakërpunuesit punishtet e tyre i kishin edhe dyqane. Prodhonin dhe shisnin objekte prej bakri.

Në pazar vinin blerës jo vetëm nga Kavaja, por edhe nga krahina të tjera rreth e rrotull.




Poçeria ka qënë dhe mbetet artizanati më përfaqësues i Kavajës.

Mjeshtrit poçarë kavajas e punonin baltën për të bërë enë të shumëllojshme, të cilat përdreshin për të mbajtur ujin, vajin, gjalpin, gjizën, djathin, turshitë e ndryshme, por edhe për të gatuar me to. Ata e punonin baltën nga shkurti deri në nëntor, pasi, me të ardhur i ftohti dimëror, balta nuk mund të modelohej.



Hulumto dhe rendit hapat e bërjes së një ene prej balte.
Rendit figurat e mëposhtme sipas radhës.



Krijo dhe ti një enë prej balte, si një mjeshtër poçar kavajas.
Vizato një enë dhe jepi asaj format që dëshiron.



A I NJIHNI KËTO OBJEKTE?

Prindërit ose gjyshërit mund
t'i njohin më mirë. A e gjen dot
se për çfarë përdreshin ato?

Disa prej tyre janë enë zjarri, e
të tjera enë uji, a e di përse?

Gjeji se cilat janë ato!



ibrik

magrip



ibrik me kaçalytë



katruve

poç balte i ngjyrosur

shtambë

kandila vaji

saksi



Kavajasi i përdornin enët prej bakri për përgatitjen e ushqimit, sepse e ruanin më mirë nxehtësinë.

Gjellët e tyre të preferuara ishin: mishi me qepë (jahnia), pilafi, japrakët, hallva dhe sidomos byreku me qumësht.



Ngjyrose këtë sini prej bakri sipas dëshirës.




VESHJET TRADICIONALE TË KAVAJËS

Gjej dhe lexo me zë të lartë veshjet tradicionale kavajase. Kombinoji ato me rrobat e sotshme për të krijuar një stil sa më të bukur. Priti dhe ngjiti ato te figurat në të majtë.



Vazhdoje ngjyrosjen e kësaj mbulese sipas dëshirës.



Unë jam konservuesja.
Kujdesem që objektet
e muzeut të ruhen
sa më mirë.

Unë jam kuratori.
Punoj që ekspozitat e
muzeut të jenë sa
më kuptimplota
dhe njohëse.

**Unë jam ciceroni i
muzeut.** Unë u rrëfej vizitorëve
të shumtë historinë dhe
veçoritë e muzeut.

Unë jam muzeologia.
Organizoj dhe përshtas
muzeun në mënyrë
që të gjithë të
kënaqen.


PROFESIONISTË QË KUJDESEN PËR MUZEUN!

**MUZEU ËSHTË NJË
VEND PËR TË GJITHË...
PËRFSHIRË DHE DISA
MIQ TË PAFTUAR.**

Ne jemi
myqe dhe na pëlqen të
strukemi kudo ku ka
lagështi.

Unë jam miu
dhe më pëlqen
të ushqhem
me tekstile dhe
letër.

Unë jam një larvë
dhe më pëlqen
të ushqhem me
objekte prej druri,
prej leshi dhe
mëndafshi.



Unë po bashkoj pjesët e një ene të thyer.

ÇFARË BËJNË KONSERVUESIT?

Konservuesit ruajnë dhe mirëmbajnë objektet në një muze, si dhe mjedisin që i rrethon ato.

Ata mund të jenë specialistë të një materiali në veçanti, si p.sh. për leshin, mëndafshin, metalet, letrën, gurin etj.

Unë po plotësoj formularin shoqërues të një objekti.





RESTAURIMI

Edhe vetë ndërtesa duhet të mirëmbahet.

Ndihmo në restaurimin e saj.

TANI PUNO DHE TI NË MUZE!

Studio një objekt në muze dhe
tregoju vizitorëve për të.



Si quhet ky objekt?

Sa i vjetër është objekti?

Me çfarë materiali është bërë ?

Prej nga vjen ky objekt?

Kush mund ta ketë bërë?

Kush mund ta ketë përdorur?

Vizato objektin e muzeut që të pëlqen më shumë.





ÇFARË TË LA MË SHUMË MBRESA NGA VIZITA NË MUZE?

A decorative border with a repeating square pattern surrounds the writing area. Inside, there are ten horizontal dashed lines for writing.



A decorative border with a repeating square pattern surrounds the writing area. Inside, there are ten horizontal dashed lines for writing.

ÇFARË DO TË DOJE TË SHIHJE KËTU?



FJALORTH

Endje gërshetimi i fijeve në tezgjah për të bërë pëlhurë.

Konservim ruajtja dhe mirëmbajtja e objekteve në një muze.

Kovaç punëtor që farkëton hekurin për të bërë vegla të ndryshme, hekurpunues.

Kulla e Sahatit kullë që ndodhet në qendër të Kavajës, të cilën e gjejmë në sheshet e disa qyteteve shqiptare. Ajo shërbente për të mbajtur orën e madhe të qytetit që shihej në largësi.

Pazar shesh i hapur në qytet, ku shiten e blihen sende artizanale, produkte ushqimore, kafshë e mallra të tjera me pakicë.

Pëlhurë copë e endur hollë zakonisht me fije pambuku a mëndafshi që përdoret për veshje të lehta apo mbulesa.

Poçar mjeshtri që bën enë kuzhine dhe vazo dekoruese prej balte.

Qeleshe kësulë e bardhë, e rrumbullakët, e cila ka forma e përmasa të ndryshme sipas krahinave.

Qilim shtrojë me përmasa të ndryshme dhe me një a me disa fletë të endura, e punuar në vegjë me fije të trasha leshi, pambuku etj., zakonisht me disa ngjyra dhe me zbukurime.

Restaurim ndërhyrjet me qëllim plotësimin dhe jetëgjatësinë e objekteve e monumenteve që janë pjesë e trashëgimisë sonë kulturore.

Trashëgimia kulturore tërësia e objekteve, veshjeve, ndërtesave, këngëve e traditave të cilat përcillen nga një brez në tjetrin.

Trashëgimia kulturore materiale gjërat e prekshme, të trashëguara brez pas brezi, të cilat kanë vlerë të madhe për ne, objektet dhe ndërtesat e vjetra, veshjet tradicionale etj.

Trashëgimia kulturore shpirtërore tërësia e këngëve, valleve, historive dhe traditave të vjetra që përcillen nga njëri brez në tjetrin.

Vegla mjet i thjeshtë që shërben për të kryer një punë.

Veshje tradicionale veshje që punohen me teknika dhe metoda të vjetra tradicionale.

Zeje mjeshtëria që ushtron dikush përditë, zakonisht duke punuar me dorë a me vegla të thjeshta, që ka shprehi dhe aftësi të posaçme, të fituara nga përvoja.



SITET E TJERA TË EU4CULTURE NË SHQIPËRI:



Teatri Kombëtar i Kukullave,
Tiranë



Muzeu Historik Kombëtar, Tiranë



Kalaja e Ishmit



Muzeu Etnografik, Durrës



Hamami, Durrës



Ministria e Kulturës, Tiranë



Ndërtesa e Institutit të Ish-të
Përndjekurve Politikë, Tiranë



Torra Venciane, Durrës



Muzeu Arkeologjik, Durrës



Ura e Kurçajt, Krujë



Kisha e Manastirit, të Rubikut



Kisha e Shën Ndojt, Rodon



Muzeu Etnografik, Krujë



Kalaja e Lezhës



Ish-Arqipeshkvia, Laç



Kalaja e Bashtovës, Rrogozhinë



Rrënojat e Kishës së Shën Mërisë,
Durrës



Muzeu Etnografik Kavajë


NË TË NJËJTIN GJERDAN LIBËRTHASH DO TË GJENI



Gjerdani i libërthave, pjesë e së cilit është dhe ky botim, është pjesë e projektit “Platformat e Fuqizimit dhe të Mësimit përmes Trashëgimisë” të financuar nga Bashkimi Evropian në kuadër të programit EU4Culture, të zbatuar nga UNOPS-i në koordinim me Ministrinë e Kulturës.

Ky projekt, i cili u zbatua nga CHwB Albania, mundësoi realizimin e katër libërthave për fëmijë mbi Muzeun Etnografik të Kavajës, Muzeun Etnografik të Krujës, Urën e Kurçajt (Krujë) dhe Kalanë e Bashtovës (Rrogozhinë). Këta libërtha u bashkëkrijuan me përfaqësues nga institucionet publike vendore e qendrore, profesionistë e qytetarë aktivë në fushën e mbrojtjes dhe promovimit të trashëgimisë kulturore nga qytetet përkatëse.

Qëllimi i këtyre libërthave është forcimi i njohurive të fëmijëve të moshave 6 - 11 vjeç mbi disa prej vlerave më të veçanta të trashëgimisë sonë kulturore, si dhe të shërbyerit si mbështetje për aktivitete praktike pranë siteve të përmendur e jo vetëm, që kanë trashëgiminë kulturore në fokus.



Muzeu Etnografik i Kavajës

Botues: Cultural Heritage without Borders Albania (CHwB Albania)

Koncepti: Mirian Bllaci, Arnold Kapinova, Natasha Paja

Konsulentë për materialin etnografik: Afërdita Onuzi, Stefanaq Sotja

Konsulente për tekstin dhe redaktimin: Luljeta Dano, Rudina Çupi.

Ilustrimet: Natasha Paja (Trivet)

Përpunimi grafik, faqosja: Natasha Paja (Trivet)

Drejtues projekti: Mirian Bllaci

ISBN: 978-9928-801-03-6

Ky libërth është krijuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e tij është përgjegjësi e vetme e CHwB Albania dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian dhe/ose UNOPS -it.

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Muzeu Etnografik i Kavajës / koncept.
Mirian Bllaci, Arnold Kapinova, Natasha Paja ; il. Natasha Paja (Trivet) ; red. e konsult.
Luljeta Dano, Rudina Çupi. - Tiranë : Cultural Heritage without Borders Albania, 2023
56 f. : me il. ; 25x25 cm.
ISBN 978-9928-801-03-6
1.Etnografia shqiptare 2.Muze 3.Botime për fëmijë
4.Kavajë 5.Shqipëri
078.5 :069(496.5)



